



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, lidhur me ekzistencën dhe funksionimin e Zyrës së Mbrojtjes së Konsumatorëve (ZMK) pranë Bashkisë Shkodër, ju bëjmë me dije se:

Aktualisht, Bashkia Shkodër nuk ka të ngritur një zyrë të posaçme për Mbrojtjen e Konsumatorit. Megjithatë, në kuadër të funksioneve të përcaktuara nga Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në zbatim të parimeve të bashkëpunimit ndërinstitucional, Bashkia është e hapur ndaj çdo propozimi, që mund të përcaktohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Në këtë fazë, është ngritur një grup pune me dy persona përgjegjës, të cilët ndjekin informacionet, trajnimet apo nismat që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit, në kuadër të përgatitjeve për ngritjen e mekanizmave të nevojshëm institucionalë. Deri më tani, nuk janë trajtuar raste apo ankesa konkrete nga qytetarët, pasi grupi i ngritur ka funksion koordinimi të brendshëm, dhe jo funksion shërbimi direkt ndaj konsumatorit.

Bashkia Shkodër mbetet e angazhuar për të ndjekur zhvillimet ligjore dhe institucionale në këtë fushë dhe për të bashkëpunuar me organizata si Qendra “Konsumatori Shqiptar” për forcimin e kapaciteteve vendore në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI